



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesë e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 379/1 Prishtinë 27-01, 2021

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Hajredin Aliu ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “**PROJEKTIMI DHE LLOGARIA E STRUKTURES NGA DRURI I LAMELUAR, SISTEM HARK PER HALLE SPORTIVE**”, në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë.

Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Ky punim përmban pjesën teorike dhe analitike.

Punimi përbëhet prej njëmbëdhjetë kapitujve.

Në pjesën e parë (teorike) të punimit është përshkruar një historik i shkurtër i zhvillimit të strukturave nga druri. Është paraqitur teknologjia e përpunimit të drurit, përparësitë dhe të metat e tij në krahasim me materialet tjera të ndërtimit siç janë betoni i armuar dhe çeliku.

Veprimet e jashtme në strukturat nga druri i lameluar si dhe kombinimet e veprimeve të jashtme sipas teorisë së gjendjes kufitare mbajtëse (ULS) dhe sipas gjendjes kufitare të përdorimit (SLS). Llogaria e ndikimeve të brendshme të tërë strukturës dhe elementeve përbërëse të tij. Është paraqitur epja e elementeve të drurit sipas EC-5 si dhe caktimi i gjatësisë së epjes tek harqet dhe ramat në rrafsh.

Janë treguar llojet e lidhjeve tek strukturat nga druri i lameluar si dhe janë paraqitur llojet e mjeteve lidhëse. Pjesa e dytë përmban pjesën analitike/numerike ku është analizuar dhe llogaritur harku nga druri i lameluar që i përket një strukture me destinim aktivitetet sportive. Analiza e tij është bërë sipas teorisë lineare me anë të elementeve të fundme vijore. Janë caktuar zhvendosjet e harkut nga veprimet ekstreme nga veprimet e jashtme.

Në fund, janë paraqitur konkluzione të përgjithshme rreth sjelljes së këtyre strukturave.

Për më tepër, aty propozohen sugjerime për studime të mëtejme lidhur me këtë grup të konstruksioneve.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.